



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1641/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Trupi Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës (TEIP) në Kosovë, kundër debitorit Telekom i Kosovës, sh.a me seli në Prishtinë, rr. “28 Nëntori” p.n., me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës se Parë KPPP.nr.2486/22 të datës 27.09.2023, me datën 05.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Telekom i Kosovës, sh.a, me seli në Prishtinë, rr. “28 Nëntori” p.n., ndërsa aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës se Parë KPPP.nr.2486/22 të datës 27.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës se Parë KPPP.nr.2486/22, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2486/22 të datës 27.09.2023, e ka refuzuar si të pabazuar propësimin e debitorit Telekom i Kosovës, sh.a me seli në Prishtinë, rr. “28 Nëntori” p.n., i paraqitur kundër urdhrorit për lejimin e përmbarimit P.nr.150/22 te datës 05.10.2020,në bazë të dokumentit përmbarues Vendim i Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës (TEIP) me nr.: 01 Nr.09-83-1446/2022 i datës 18.01.2022 me të cilën është detyruar debitori Telekom i Kosovës, sh.a, që kreditorit në emër të ndëshkimit administrativ për shkeljen e nenit 17 par.2 të Ligjit të Punës e sanksionuar me nenin 92 të Ligjit të Punës, bazuar në nenin 7 par.2 pika 2.7 të UA. Nr.07/2012 për përcaktimin e gjobave dhe shumave konkrete për shkeljen e dispozitave të Ligjit të Punës, t’ia paguaj shumën prej 1500.00 EUR (njëmijë e pesëqind euro) € si dhe të paguhen shpenzimet e procedurës përmbarimore në pajtim me tarifat në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës përmbarimore, konstatimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ankesën si te bazuar, aktvendimin e shkalles se parë ta prish dhe çështja te kthehet ne shkalle te parë ne rivendosje .

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje ne ankesë

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 01.11.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbartues Vendim i Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës (TEIP) me nr.: 01 Nr.09-83-1446/2022 i datës 18.01.2022 me të cilën është detyruar debitori Telekom i Kosovës, sh.a, që kreditorit në emër të ndëshkimit administrativ për shkeljen e nenit 17 par.2 të Ligjit të Punës e sanksionuar me nenin 92 të Ligjit të Punës, bazuar në nenin 7 par.2 pika 2.7 të UA. Nr.07/2012 për përcaktimin e gjobave dhe shumave konkrete për shkeljen e dispozitave të Ligjit të Punës, t'ia paguaj shumën prej 1500.00 EUR (njëmijë e pesëqind euro) € si dhe të paguhen shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me tarifat në fuqi.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbartimor me arsyetimin se Përmbartuesi Privat ka tejkaluar kompetencat ligjore duke shkelur dispozitat e LPP-së pasi që Gjykata është kompetente që të vendos në procedurën e përmbartimit dhe të vendos për përmbartimin e vendimeve gjyqësore lidhur me kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë dhe kompensime tjera. Ka shtuar se debitori për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të Ligjit nr.03/L-212 dhe aplikimit të drejtës materiale brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë dhe ka kërkuar që deri sa të vendos organi i shkallës së dytë lidhur me ankesën të shtyhet ekzekutimi i vendimit konform nenit 61 par.1.1. Andaj, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e debitorit si të bazuar.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës se Parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar për shkaqet si në vijim: Me nenin 21 të LPP-së përcaktohet se: “Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.” Ndërsa, me nenin 22, par.1 nën-par 1.2 përcaktohet se: 1. Dokumente përmbartuese janë: ... 1.2. vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia)”.

Gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar dokumentin– Vendim i Inspektorati i Punës me nr.: 01 Nr.09-83-1446/2022 i datës 18.01.2022, në bazë të së cilit përmbartuesi privat ka lejuar

përmbardimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbardues sipas të cilit mund të caktohet përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata tutje gjeti se Vendimi i përmbard të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: “Dokumenti përmbardimor është i përshtatshëm për përmbardim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbardjes së detyrimit”, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbardjes së detyrimit.

Dhoma e shkallës së parë gjeti se vendimi i lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara edhe në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: “Së bashku me propozimin për përmbardim, organit përmbardues i dorëzohet edhe dokumenti përmbardues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbardueshmëris për përmbardueshmëri”, ngase i njëjti është bërë i formës së prerë me datë 14.10.2022 dhe i ekzekutueshëm prej datës 14.10.2022.

Tutje dhoma e shkallës së parë me rastin e vendosjes pati parasysh pretendimet e debitorit se vendimi mbi bazën e të cilit është lejuar përmbardimi nuk ka marrë formën e prerë, pasi që ende nuk është vendosur në lidhje me ankesën e tij nga organi i shkallës së dytë, por që këtë pretendim e vlerësoj si të paqëndrueshëm për faktin se në kuptim të nenit 6.4 të Ligjit nr. 2009/9 për Inspektoratin e Punës, ankesa ndaj vendimit nuk e shtyen ekzekutimin, andaj përmbardimi është lejuar në përputhje me nenin 24, par.5 të LPP-së i cili parasheh se “Përmbardimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po qe se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbardimin”.

Po ashtu shkalla e parë i vlerësoj pretendimet e debitorit se Përmbarduesi Privat ka tejkaluar kompetencat ligjore duke shkelur dispozitat e LPP-së pasi që Gjykata është kompetente që të vendos në procedurën e përmbardimit dhe të vendos për përmbardimin e vendimeve gjyqësore lidhur me kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë dhe kompensime tjera, por këto pretendime i vlerësoj si të pabazuara për faktin se në rastin konkret, kemi të bëjmë me procedurë përmbardimore të iniciuar nga organi administrativ ndaj subjektit juridik, për ekzekutim të detyrimit monetar sipas vendimit të organit administrativ, dhe jo kontest pune për realizimin e të drejtave të vërtetuara nga marrëdhënia e punës, andaj, në kuptim të nenit 5.5 të LPP-së, organi përmbardues është kompetent për lejimin e përmbardimit mbi bazën e vendimit nr.: 01 Nr.09-83-1446/2022 i datës 18.01.2022.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbardimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbarduesit privat, me të cilin është caktuar përmbardimi i propozuar nga kreditori. Kjo gjykatë vlerëson se Vendimi i Inspektorati të Punës me nr.: 01 Nr.09-83-1446/2022 i datës 18.01.2022, është dokument përmbardues dhe i përshtatshëm për përmbardim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “ *Dokument përmbardues është edhe vendimi përmbardues i dhënë në procedurë administrative*

dhe aktpajtimi (me tej: ujdia) ” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu është në pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 të LPP i cili përcakton se: “Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit ”, ndërsa një dokument përmbarimor për të shërbyer si titull përmbarues patjetër duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbarimor.

Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “ *Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri ”*, ngase i njëjti është bere i formës së prerë me datën 14.10.2022 dhe i ekzekutueshëm prej datës 14.10.2022. ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “ *Vërtetimin për përmbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë ”*. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbarim. Arsye këto nga të cilat edhe kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e debitorit janë të paargumentuara dhe si të tilla mbeten vetëm në natyrën deklarative, të pambështetura në prova ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 të LPP.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par.1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.Shk II.nr.1641/23 me datë 05.03.2024

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**